



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

831
15.02.2016

Nr. Rregj. Them. 6953/2412/393

Nr. Vendimit 152

Data e rregjistrimit 09.09.2014

Data e vendimit 04.02.2016

VENDIM
NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata Administrative e Apelit, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët:

Lindita SINANAJ	KRYESUESE
Artur MALAJ	ANETAR
Alkelina GAZIDEDJA	ANETARE

me sekretare gjyqesore *Visela Kashari*, në Tiranë, sot me datë 04.02.2016, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen administrative, që i përket palëve:

PADITËSE: *Shoqëria "Çaushi"*, shpk, me administrator Enver Çaushi,
adresa: Ura Vajguore, Berat.

TË PADITUR: *-Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë.*
-Drejtoria Rajonale Tatimore, Dega Berat.

OBJEKTI: Kundërshtim Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore,
nr. 1917 prot., datë 30.06.2011, të Drejtorisë Rajonale
Tatimore Berat, në vlerën 500.000 lekë.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 32, 45 të K.Civil, nenet 118 e 119 të K.Pr.Administrative, ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

joi relatorin e çështjes, shqyrtoi pretendimet e parashtruara në ankim nga pala e paditur
i Rajonale Tatimore, Dega Berat, që kërkon:

imin e vendimit Nr. 646, datë 26.04.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe e padisë.

oi çështjen në tërësi:

VEREN

tën Administrative të Apelit në datën 09.09.2014, është regjistruar ankim i paraqitur
turi Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, kundër vendimit Nr. 646, datë 26.04.2012 të
ë Rrethit Gjyqësor Berat, bazuar në nenet 442, 443 të K.Pr.Civile dhe nenin 48 të
49/2012 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin
ëveshjeve Administrative". Ky ankim fillimisht është regjistruar në Gjykatën e Apelit
atën 27.09.2012. Kjo gjykatë me vendimin Nr. 863, datë 15.05.2014, bazuar në nenet
Ligjit Nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe
nosmarrëveshjeve administrative", ka shpallur moskompetencën e saj për gjykimin e
eje duke dërguar aktet për kompetencë gjykimi në Gjykatën Administrative të Apelit
ë fillimit të funksionimit të Gjykatave Administrative në datën 04.11.2013, si dhe
ndimit Unifikues Nr. 3, datë 06.12.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së

dosjes së gjykimit rezulton se në datën 25.11.2011, pala paditëse i është drejtuar
Rrethit Gjyqësor Berat, me padinë objekt gjykimi. Kjo Gjykate me vendimin Nr.

i, datë 26.04.2012, ka vendosur: "Anullimin e aktit administrativ, Njoftim Vleresimin për
vrimet Tatimore, me nr.1917 prot., date 30.6.2011, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat, ne
ën 500.000 leke, ne ngarkim te subjektit Shoqëria "Caushi", shpk, me administrator z. Enver
shi dhe të Vendimit te Drejtorisë së Apelit me nr. 14777/1 prot., datë 25.10.2011.
nizimet gjyqësore në masën 52.000 lekë në ngarkim të palëve të paditura. Kunder vendimit
d të bëhet ankim brenda afatit ligjor në Gjykatën e Apelit Vlore."

ër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat ka paraqitur ankim pala e paditur
oria Rajonale Tatimore, Dega Berat, duke parashtruar këto pretendime:

Vendimi i Gjykatës është rezultat i interpretimit të gabuar të ligjit.
Gjatë kontrollit të ushtruar nga inspektorët e hetimit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier,
ka rezultuar se paditësi nuk kishte instaluar kasën fiskale, duke vepruar në kundërshtim
me nenin 55 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e
Shqipërisë", Udhëzimin nr.24, datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", të
ndryshuar, Kreu VI, pika 55 dhe në VKM-në nr.781, datë 14.11.2007, të ndryshuar.
Penalizimi për paditësin në masën 500 000 lekë është vendosur në përputhje me nenin
122, pika 1, germa a/i, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në
Republikën e Shqipërisë". Njoftim vlerësimi për detyrimin tatimor nr. 1917, datë
30.06.2011 i DRT Berat, që konfirmon penalitetin është lënë në fuqi me vendimin nr.
4777/1, datë 25.10.2011 të Drejtorisë së Apelit Tatimor në DPT Tiranë.
Pajisja fiskale e paditësit nuk figuron në listën e pajisjeve të certifikuara nga shoqëria. Në
momentin e kontrollit, është dorëzuar një kopje e printuar e faqes zyrtare të internetit të
DPT Tiranë.
Paratura e vendosur nga paditësi nuk transmeton të dhënat on-line në DPT, ashtu siç
parashihet në pikën 4 të VKM-së nr. 781, datë 17.04.2007.
Për paditësin nuk është rasti i parë i penalizimit për mungesë të pajisjes fiskale, ndaj dhe
vendosur është e drejtë dhe e bazuar ligjshëm. Shkelja e konstatuar është në
përputhje me penalitetin.

i sipër ankuesi ka kërkuar ndryshimin e vendimit Nr. 646, datë 26.04.2012 të
Rrethit Gjyqësor Berat dhe rrëzimin e padisë.

Faktet e parashtruara para gjykatës

Paditësi Shoqëria "Çaushi", shpk, ushtron aktivitet privat në fushën e tregëtimit me pakicë të carburanteve, veprimtari për të cilën është e liçencuar si person fizik me nr. nipti K 32803004 T. Kjo Shoqëri, veprimtarinë e kryen në adresën Ura e Kucit- Berat. Midis shoqërisë CKV-NOKI ALBANIA dhe palës paditëse, shoqërisë "Çaushi" sh.p.k, është lidhur kontrata "Fiskalizimi i carburantit" në datën 10.04.2010. Në datën 09.06.2011, nga ana e Inspektorëve të Hetimit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier është ushtruar kontroll pranë subjektit Shoqëria "Çaushi", shpk, gjatë të cilit është mbajtur Akt-Konstatimi dhe procesverbali i gjobës me nr. 0045905 në datën 09.06.2011, sipas së cilës rezultojnë të jenë refuzuar të firmosen nga paditësi. Referuar këtij procesverbali gjobe, për paditësin është vendosur gjoba në shumën 500.000 lekë me arsyetimin e nga kontrolli i ushtruar në subjekt i cili është penalizuar me pare me gjobe në masën 100.000 lekë për mosinstalim pajisje fiskale, u konstatua se subjekti nuk kishte instaluar pajisjen fiskale për regjistrimin e pagesave me para në dore. Me Njoftim Vlerësimin për Detyrimet Tatimore nr. 917, datë 30.06.2011 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat, subjekti Shoqëria "Çaushi" shpk" është njoftuar për detyrimin tatimor si më sipër, kundër të cilit ka paraqitur ankim me shkresën nr. 5 prot., datë 24.07.2011 në Drejtorinë e Apelit Tatimor, e cila me vendimin nr. 14777/1 rot., datë 25.10.2011 ka vendosur "Lënien në fuqi të aktit administrativ, objekt ankimi administrativ, Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore nr. 1917, datë 30.06.2011, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat dhe rrëzimin e ankimit." Vendimi i DAT i është njoftuar palës paditëse me shkresën nr. 14777/1 prot., datë 25.10.2011.

Në këto kushte, paditësi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, duke kërkuar anulimin e njoftim vlerësimi nr. 1917 prot., datë 30.06.2011, kërkesë e cila është vlerësuar dhe bazuar në ligj dhe në prova, arsye për të cilën është disponuar me vendim për pranimin e saj.

Vlerësimi i çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit

ë pari gjykata vlerëson të evidentojë kompetencën e saj për shqyrtimin e ankimit objekt i këtij gjykimi. Në referim të nenit 7 gërma "a", nenit 10 paragrafi 2 gërma "a" dhe nenit 44 të Ligjit nr. 49/2012, kjo gjykatë ka kompetencën lëndore dhe funksionale për gjykimin e kësaj çështjeje.

Së dyti gjykata vlerëson të rimarrë në shqyrtim kushtet e pranueshmerisë së ankimit. Sikurse është referuar edhe më sipër në këtë vendim, rezulton që vendimi të jetë shpallur në datën 26.04.2012, kurse ankimi nga pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore, Dega Berat është paraqitur në datën 04.05.2012, pra dukshëm brenda afatit pesëmbëdhjetë ditor të përcaktuar në nenet 443 paragrafi i parë dhe 444 paragrafi i parë të K.Pr.Civile. Po kështu, nuk rezulton të ekzistojnë kriteret penguese të parashikuara në nenin 45 të Ligjit Nr. 49/2012 që e bejnë vendimin të paankimueshëm. Ankimi rezulton të jetë i plotë edhe në elementët e tjerë, si në elementët e formës edhe të përmbajtjes, lidhur me nënshkrimin nga pala që e ka paraqitur, tregimin e palëve ndërgjyqëse, vendimin kundër të cilit është paraqitur ankimi, apo kërkimet për të cilat është paraqitur ky ankim. Për të gjitha sa më sipër gjykata çmon se ankimi i paraqitur kundër vendimit Nr. 646, datë 26.04.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, objekt gjykimi, duhet të pranohet për shqyrtim.

Së treti Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor të zhvilluar në shkelje të rënda të rregullave procedurale mbi përfaqësimin, shkelje këto që passjellin pavlefshmërinë e vendimit dhe të procedurës së gjykimit. Nga aktet e dosjes gjyqësore konstatohet se gjykimi i kësaj çeshtjeje është zhvilluar pa u thirrur në gjykim Avokatura e Shtetit.

Në nenin 79/a të K.Pr.Civile është parashikuar se: *"Avokatura e Shtetit ushtron përfaqësimin në rastet e parashikuara me ligj. Gjykata, që shqyrton çeshtje për të cilat me ligj përfaqësimi dhe mbrojtja kryhet nga Avokatura e Shtetit, urdhëron njoftimin e akteve kësaj të fundit, me qëllim që ajo të ketë mundësi të marrë pjesë në gjykim."*

Në nenin 2 pika 2 te ligjit Nr. 10018 date 13.11.2008 parashikohet se: *"Avokatura e Shtetit është institucion qëndror i administratës publike, i ngarkuar ekskluzivisht për dhënien e asistencës juridike për institucionet shtetërore dhe entet publike. Asistenca juridike përfshin shërbimin këshillimor dhe të përfaqësimit. Për institucionet dhe për çeshtjet juridike të përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji, asistenca juridike e Avokaturës së Shtetit është e detvrueshme. Në Avokaturën e Shtetit, funksioni i këshillimit juridik kryhet ekskluzivisht nga avokatët e shtetit."*

rse në nenin 5 pika 1 germa "b" të këtij ligji është përcaktuar se: "1. Avokatura e Shtetit kryen funksionet e mëposhtme:

b) përfaqëson dhe mbrohet interesat pasurore të shtetit shqiptar pranë gjykatave kombëtare, të kombëtare dhe të huaja, pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit në çështjet gjyqësore, të cilat një organ i administratës shtetërore ose Republika e Shqipërisë është palë. Në çështje veçanta, sipas kritereve lëndore dhe sasiore, të përcaktuara në rregulloren e miratuar nga Shilli i Ministrave, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit mund t'ia delegojë të drejtën e përfaqësimit e të mbrojtjes organit të interesuar të administratës;...."

Në interpretim të dispozitave të mësipërme kjo Gjykatë vlereson se ligji Nr. 10018/2008 ka rrahikuar domosdoshmërinë e përfaqësimit dhe mbrojtjes së interesave pasurore të shtetit nga avokatura e Shtetit në çështjet gjyqësore në të cilat është palë një organ i administratës shtetërore. Në rastin në gjykim kjo gjykatë vlereson se është domosdoshmëri përfaqësimi i palëve të paditura, Drejtoria Rajonale Tatimore Berat dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nga Avokatura e Shtetit, për më tepër kur në objektin e padisë kërkohet pavlefshmëria e aktit administrativ "Njoftim Vlerësimi për Detyrim Tatimor" me nr.1917 prot., datë 30.06.2011, i cili përmban detyrim për tu paguar me vlera në të holla, në shumën prej 500 000 lekësh.

Sipas germës "ç" të nenit 50 të ligjit nr. 49/2012, Gjykata Administrative e Apelit në dhomë të bashkuar shpreh vendimin dhe kthimin e çështjes për rigjykim në rastin kur shkeljet procedurale janë të rënda dhe për të cilat ligji parashikon shprehimisht pavlefshmërinë e vendimit apo të procedurës së gjyqësimit. Kurse në nenin 54 germa "d" të ligjit Nr. 49/2012 është parashikuar se Gjykata Administrative e Apelit prish vendimin e gjykatës administrative të bashkuar në të parë dhe ia dërgon çështjen organit kompetent për rigjykim kur gjykata ka shkelur dispozitat lidhur me përfaqësimin e palëve. Në rastin në gjykim Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka shkelur rëndë rregullat mbi përfaqësimin e organeve të administratës shtetërore nga Avokatura e Shtetit, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e sipercituara të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit Nr. 10018/2008.

Duke u bazuar në sa më sipër dhe duke ju referuar për zbatim Vendimit Unifikues Administrativ të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë Nr. 3 datë 06.12.2013, Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenin 50 germa "ç" të ligjit Nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e

*gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative", përfundimisht
shpallin të kundërt të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat duhet prishur dhe çështja duhet dërguar
për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlore.*

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenet 49 e 50, germa "ç" të ligjit Nr. 49/2012
"Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e
mosmarrveshjeve administrative".

VENDOSI

shpalljen e vendimit Nr. 646, datë 26.04.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe dërgimin
për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlore.

miratuar me 04.02.2016

ANETARE

Alkelina GAZIDEDJA
dv

ANETAR

Artur MALAJ
dv

KRYESUESE

Lindita SINANAJ
dv

Vertetohet njësia me origjinalin

*Kancelari
Lindita Sinanaj
Malaj*